

# IDETË TONA



# VLERËSOHEN

# TË GJITHË I KEMI TË DREJTAT E BARABARTA


DIELLZA (10), BLERTON (10), ERIS (10), ARDI (10), SHKUMBIN (11), LAVDRIM (10), ELINA (10),  
GENTIANA (11)



**Pse është e rëndësishme të jetojmë në demokraci? Cili është kontributi ynë në zhvillimin e mëtutjeshëm të demokracisë? Këto dhe shumë informata të tjera do t'i mësoni në artikullin më poshtë**

Demokracia është qeverisje e popullit. Populli qeveris me anë të votës. Në demokraci të gjithë duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë pa asnjë lloj dallimi të mundshëm. Demokracia brenda vetes përfshin edhe disa elemente të tjera, të cilat janë: liria, toleranca, shprehja e lirë e mendimit, sovraniteti, zgjedhja e lirë, etj. Këto elemente duhet të zbatohen nga të gjithë qytetarët, të cilët e duan zhvillimin e vendit të tyre. Demokracia është dëshmuar si një prej sistemeve më të mira të qeverisjes, sepse vetë populli vendos për të ardhmen e tij. Po ashtu, në demokraci mendimi i gjithsecilit ka vlerë të madhe dhe roli aktiv i secilit qytetar mund të ndikojë në rritjen e zbatimit të ele-

menteve të demokracisë. Pra, kërkohet nga të gjithë ne që të marrim iniciativa pozitive për të mirën e vendit. Janë të njohura dy forma të demokracisë: demokracia e drejtpërdrejtë, ku vendimet shtetërore merren në mënyrë direkte dhe demokracia përfaqësuese, ku populli duhet të zgjedhë përfaqësuesit që do të flasin në emër të tij. Demokracia përfaqësuese i ka edhe dy sisteme, të cilat janë: sistemi parlamentar dhe sistemi presidencial. Për shembull, Kosova ka demokraci përfaqësuese me sistem parlamentar, sepse populli i zgjedhë deputetët, pastaj deputetët e zgjedhin Presidentin. Ndërsa SHBA ka demokraci përfaqësuese presidenciale, sepse populli e zgjedh direkt Presidentin. Këto ishin disa informata për demokracinë, të cilat shpresojmë se do t'iu shërbejnë në të ardhmen. Ne po ashtu kemi një mesazh për ju: na ndihmoni ta ndërtojmë edhe më shumë demokracinë, sepse ne kemi fuqi të vendosim për mënyrën e jetesës tonë.



Barazia është elementi kyç i demokracisë



Ne jemi e ardhmja e vendit

# NDIKIMI I ZGJEDHJEVE NË VENDIN TONË

DORETA (10), ERLETA (10), ALBION (10), ANDETA (10), YLLI (10), BLERTONI (10), EDMONDI (10)

## Demokracia dhe zgjedhjet


Me fjalën demokraci kuptojmë lirinë e popullit, të drejtat e barabarta, tolerancën dhe respektin ndaj njëritjetrit.

Zgjedhjet bëhen nga qytetarët dhe bëhen sipas dëshirës së tyre. Procesi zgjedhor në demokraci është shumë i rëndësishëm, sepse populli zgjedh përfaqësuesit e vet dhe këta përfaqësues zgjedhen me anë të votave. Për të votuar në procesin zgjedhor kanë të drejtë ata qytetarë, të cilët janë mbi moshën 18 vjeçare. Në Kosovë janë dy lloje të zgjedhjeve: zgjedhjet komunale, ku populli zgjedh kryetarin e komunës dhe asambleistët si dhe zgjedhjet qendrore ose parlamentare, ku populli zgjedh deputetët.


Grupi ynë ka një mesazh për ju që e lexuat këtë artikull: vota ndikon në vendin në të cilin ti jeton, prandaj për të ndryshuar vendin duhet të votosh.




Grupi „Thesari“




Për të ndikuar në të ardhmen tënde, voto



Deputeti, përfaqësues i popullit



Ne kemi të drejtën e lojës në demokraci



Në këtë vizatim është paraqitur kutia e votimit






Kosova është shtet i pavarur dhe demokratik




Ne e ndihmojmë njëri-tjetrin




Kuvendi i Kosovës ka 120 deputetë



Toleranca, liria, barazia janë elemente të demokracisë



Të gjithë duam të jetojmë në paqe dhe në liri



Këto janë dy llojet e demokracisë



Ne bashkëpunojmë për të bërë punë më të mirë



Pushteti Legjislativ është Kuvendi



## VENDI KU MBROHEN INTERESAT TONA

ENDRITI (10), ARTA (11), ERONI (10), SUELA (10), RIAD (10), ARTESA (10), ISA (11)



**Kuvendi është institucioni ku punojnë deputetët, të cilët bëjnë miratimin ose mos miratimin e ligjeve me anë të votave**

Sot është një ditë e veçantë për ne, sepse mësuam shumë gjëra të rëndësishme të cilat na e qartësojnë



**Gazetaret duke e shkruajtur artikullin**

mënyrën se si funksionon shteti ynë. Formë e qeverisjes në shtetin tonë është demokracia, ku ne si qytetarë ushtrojmë sovranitetin tonë përmes zgjedhjes së deputetëve.

Këta deputetë i vënë në funksion ligjet të cilat e lehtësojnë jetën tonë, e këtë e bëjnë me anë të votave. Për shembull, mundësia që ne si nxënës të vijmë këtu dhe të diskutojmë për Kuvendin dhe shumë tema të tjera, është diçka shumë e drejtë, sepse këto koncepte që i kemi diskutuar këtu, do të mbesin në kujtesën tonë

për një kohë të gjatë. E mundësi të tilla, duhet të na ofrohen edhe më shumë, sepse kjo tregon që kjo organizatë që e vizituar sot së bashku me udhëheqësit tanë, po mendojnë për ne nxënësit.

Deputetët gjithashtu janë ata të cilët e zgjedhin udhëheqësin e Qeverisë, i cili është Kryeministri, por ata e zgjedhin edhe Presidentin e shtetit tonë. Kjo nënkupton që institucionet tona edhe pse janë të ndara, ato prapëseprapë bashkëpunojnë me njëra-tjetrën.

Arsyeja pse është e rëndësishme të dijmë për Kuvendin është se me punën që e bëjnë deputetët, jeta jonë bëhet më e lehtë dhe ne përjetojmë demokracinë duke i shprehur mendimet tona dhe duke u ndjerë të barabartë me të gjithë të tjerët.

Bashkëqytetarë të dashur, ne urojmë që të gjithë së bashku ta gëzojmë demokracinë, por edhe të punojmë që e ardhmja e vendit tonë të jetë edhe më e mirë.



**Ne punojmë për një demokraci të mirëfilltë**





## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale  
shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:  
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Skënder Emërllahu“  
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V-1 & V-2  
Website: www.demos-ti.org Vendi: Ramjan, Viti